

**L I G J**  
**Nr.9081, datë 19.6.2003**

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË  
DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR DORËZIMIN E PERSONAVE  
NË GJYKATËN NDËRKOMBËTARE PENALE"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dorëzimin e personave në Gjykatën Ndërkombëtare Penale", nënshkruar në Tiranë më 2.5.2003.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr. 3869, datë 30.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË  
BASHKUARA TË AMERIKËS NË LIDHJE ME DORËZIMIN E PERSONAVE NË GJYKATËN  
NDËRKOMBËTARE PENALE**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në vazhdim "Palët":  
duke afirmuar rëndësinë e sjelljes përpara drejtësisë të personave që kryejnë genocid, krime kundër  
njerëzimit, si dhe krime lufte;

duke rikujtuar që Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale i përpiluar në Romë, më 17 korrik 1998,  
nga konferenca diplomatike e të plotfuqishmëve të Kombeve të Bashkuara për krijimin e një Gjykate Ndërkombëtare  
Penale, ka për qëllim të plotësojë dhe jo të zëvendësojë juridiksionin penal kombëtar;

duke pasur parasysh që secila prej palëve ka shprehur synimin e saj për të hetuar dhe për të ndjekur  
penalisht, kur e shohin me vend, veprimet brenda juridiksionit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për të cilat  
pretendohet se janë kryer nga zyrtarët, nëpunësit, personeli ushtarak apo nënshtetasit e tjerë të tyre;

duke pasur parasysh nenin 98 të Statutit të Romës, bien dakord si më poshtë:

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, "persona" janë zyrtarë të tanishëm apo të mëparshëm të Qeverisë, të  
punësuar (përfshirë edhe kontraktuesit) ose personel ushtarak apo nënshtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

2. Personat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, në  
mungesë të miratimit të shprehur prej Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës:

a) nuk do të dorëzohen apo nuk do të transferohen në asnjë mënyrë në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për  
çfarëdo qëllimi ose

b) nuk do të dorëzohen apo nuk do të transferohen në asnjë mënyrë në një entitet tjetër ose vend të tretë apo  
të dëbohen në një vend të tretë, me qëllim dorëzimin apo transferimin në Gjykatën Ndërkombëtare Penale.

3. Kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë ekstradon, dorëzon ose ndryshe transferon një person të Shteteve  
të Bashkuara të Amerikës në një vend të tretë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk do të pranojë dorëzimin apo  
transferimin e këtij personi në Gjykatën Ndërkombëtare Penale nga një vend i tretë, pa miratimin e shprehur të

Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

4. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me një shkëmbim notash, të cilat do të konfirmojnë që secila Palë ka përmbushur kërkesat e domosdoshme të legjislacionit të brendshëm për ta sjellë Marrëveshjen në fuqi. Do të vazhdojë të jetë në fuqi deri një vit pas datës, kur njëra Palë njofton tjetrën për synimin e saj për t'i dhënë fund kësaj Marrëveshjeje. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të jenë të vlefshme për çdo akt që do të kryhet apo çdo akuzë që do të ngrihet, përpara datës efektive të mbarimit të Marrëveshjes.

Përfunduar në Tiranë, në dublikatë, më datë 2 maj 2003 në gjuhët shqipe dhe angleze. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, do të merret parasysh teksti në gjuhën angleze.